

Emri i Lëndës : Metodat e Mësimdhënies së Aftësive Gjuhësore të Gjuhës Angleze në AMU

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 543	B	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00

Lektori	Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.
Asistenti	
Gjuha e kursit	Anglisht
Niveli i lëndës	Master
Përshkrimi	Ky kurs i njeh studentët me bazat e mësimdhënies së katër aftësive: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit në arsimin e mesëm të ulët. Përveç bazës teorike, koncepteve dhe terminologjisë që lidhen me secilën aftësi, kursi i prezanton studentët me shembuj/modele mësimesh për secilën aftësi duke vënë theksin në aspektet/hapat kryesore të mësimdhënies efektive: metodologjinë dhe teknikat e mësimdhënies, praktikën dhe strategjitë që mund të përdorë nxënësi, si dhe qortimin e gabimeve dhe vlerësimin. Gjithashtu, ai inkurajon studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe reflektuese me qëllim zhvillimin e perceptimit individual për metodat dhe strategjitë e mësimdhënies si dhe të përgatisin një model mësimi për secilën aftësi.
Objektivat	Studenti njihet me specifikat e secilës aftësi, strategjitë, për mësimdhënien e tyre, mënyrat e vlerësimit dhe qortimit të gabimeve, në grup-mosha e arsimit të mesëm të ulët Kuptojnë rëndësinë e mësimdhënies së secilës aftësi, dhe praktikojnë njohuritë teorike nëpërmjet përgatitjes së orëve mësimore për secilën aftësi.
Konceptet Kryesore	1.Aftësitë, të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, nxënësit adoleshentë, 2. Veprimtari para, gjatë dhe pas 3. Strategjitë e mësimdhënies, puna individuale, puna në grup. 4.vështrësitë dhe strategjitë e nxënësit 5. Mësimdhënia e gramatikës dhe fjalorit 6.Qortimi i gabimeve 7.Vlerësimi i mësuesit dhe i nxënësit

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Mësimdhënia e sistemit gjuhësor, integrimi i katër aftësive. Aftësia e të dëgjuarit dhe ndikimi i saj në përvetësimin e gjuhës. Aspekte të të dëgjuarit, çfarë e bën dëgjimin të vështirë, veprimtari të ndryshme për të ushtruar dhe kontrolluar aftësinë e dëgjimit sipas niveleve, veprimtari dhe mënyra për të kontrolluar dhe vlerësuar aftëinë e dëgjimit në klasë, Përshtatja me nivelin dhe grupmoshën a adoleshencës (Linse&Nunan.ch.2; Brown, chapter 16)
2	Model i një ore mësimi për aftësinë e të dëgjuarit, objektivat, teknikat për realizimin e saj, modele mësimi të përgatura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)
3	Aftësia e të lexuarit dhe ndikimi i saj në përvetësimin e gjuhës. Aspekte të të lexuarit, çfarë e bën leximin të vështirë për grupmoshën e adoleshencës, veprimtari të ndryshme për të ushtruar dhe kontrolluar aftësinë e të lexuarit sipas niveleve për grupmoshën e adoleshencës, veprimtari dhe mënyra për të kontrolluar dhe vlerësuar aftëinë e leximit në klasë Linse&Nunan, ch4, Brown, chapter 18)
4	Model i një ore mësimi për aftësinë e të lexuarit, objektivat, teknikat për realizimin e saj modele mësimi të përgatura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)

5	Aftësia e të folurit dhe ndikimi i saj në përvetësimin e gjuhës. Aspekte të të folurit, çfarë e bën të folurin të vështirë, veprimtari të ndryshme për të ushtruar dhe kontrolluar aftësinë e të folurit sipas niveleve dhe grupmoshëve të adoleshencës, veprimtari dhe mënyra për të kontrolluar dhe vlerësuar aftësinë e të folurit në klasë, qortimi i gabimeve në të folur (Linse&Nunan, ch 3, Brown, chapter 17)
6	Model i një ore mësimi për aftësinë e të folurit, objektivat, teknikat për realizimin e saj modele mësimi të përgatitura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)
7	Vlerësimi në grup-moshën e adoleshencës, vlerësimi i vazhdueshëm dhe përfundimtar, karakteristika që vlerësimi për këtë grup-moshë (Linse&Nunan, ch 7)
8	Provim gjysmë-final
9	Aftësia e të shkruarit dhe ndikimi i saj në përvetësimin e gjuhës. Qasje të ndryshme për mësimdhënien e të shkruarit, llojet e gjuhës së shkruar, çfarë e bën të shkruarin të vështirë, veprimtari të ndryshme për të ushtruar dhe kontrolluar aftësinë e të shkruarit, veprimtari dhe mënyra për të kontrolluar dhe vlerësuar aftësinë e të shkruarit në grupmoshën e adoleshencës (Linse&Nunan, ch 5, Brown, ch 19)
10	Model i një ore mësimi për aftësinë e të shkruarit, objektivat, teknikat për realizimin e saj, modele mësimi të përgatitura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)
11	Mësimdhënia e gramatikës, roli i saj në përvetësimin e gjuhës, mënyra të ndryshme për mësimdhënien e saj, qortimi i gabimeve gramatikore në të shkruar dhe të folur, pspecifika e mësimdhënies së gramatikës në grupmoshën e adoleshencës, (brown, ch 20, Ellis current trends in the teaching of grammar)
12	Model i një ore mësimi për mësimdhënien e gramatikës, objektivat, teknikat për realizimin e saj, modele mësimi të përgatitura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)
13	Mësimdhënia e fjalorit, roli i saj në përvetësimin e gjuhës, mënyra të ndryshme për mësimin e fjalorit në grupmoshën e adoleshencës, mënyra për vlerësimin e fjalorit të nxënësit, (Linse&Nunan, ch 6)
14	Model i një ore mësimi për mësimdhënien e fjalorit, objektivat, teknikat për realizimin e saj, modele mësimi të përgatitura nga studentët, vlerësim, diskutime dhe sugjerime të studentëve për organizimin e orës (punime të studentëve)
15	Çështje themelore në mësimdhënien e gjuhës angleze në grup-moshat e adoleshencës, menaxhimi i klasës, nxënësit me aftësi ndryshe, teknologjia dhe mbështetja profesionale (Linse&Nunan, ch 9)
16	Final Exam

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Burns, A., & Siegel, J. (2018). Teaching the four language skills: Themes and issues. International perspectives on teaching the four skills in ELT, 1-17. • Linse, C., Nunan, D. (2005). Practical English Language Teaching to young learners. MacGraw Hill
Referenca të tjera	• Ellis, R. (2006). Current issues in the teaching of grammar: An SLA perspective. TESOL quarterly, 40(1), 83-107 • Watkins, P. (2018). Teaching and Developing Reading Skills Google EBook: Cambridge Handbooks for Language Teachers. Cambridge University Press. • Varmer, J. (2007). How to teach English. Pearson education Limited
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti njeh konceptet dhe terminologjinë bazë për secilën aftësi
2	Studenti njeh tiparet dalluese të secilës aftësi dhe strategji specifike për mësimdhënien e tyre tek mosha e adoleshencës
3	Studenti analizon dhe shpjegon modele mësimi të katër aftësive me tiparet dalluese tek mosha e adoleshencës
4	Studenti vlerëson në mënyrë kritike strategji të ndryshme të mësimdhënies për secilën aftësi tek mosha e adoleshencës
5	Studenti njeh, zgjedh dhe përgatit veprimtari dhe modele mësimi për secilën aftësi tek mosha e adoleshencës
6	Studenti përdor strategji, qasje dhe teknika të ndryshme për zhvillimin e aftësive marrëse dhe prodhuese të nxënësit tek mosha e adoleshencës

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	25	
Kuize	0	0	
Projekte	1	25	
Projekte semestrale	1	25	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			75
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			25
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	2	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	2	10	20
Ngarkesa totale e orëve			146
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.84
ECTS			6.00